



Prishtinë: 27.08.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1281_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2056_06_20**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **25.06.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 27.08.2020, nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Sh.S. nga fshati Dardhishtë, Fushë Kosovë, si e pa bazuar.
- II. **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, me nr. ZRrE/DMK_V_2056_06_20, i datës 02.06.2020.

A r s y e t i m

Me Vendimin nr.ZRrE/DMK_V_2056_06_20 të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, i datës 02.06.2020 është vendosur që të aprovohet ankesa e konsumatorit Sh.S. nga fshati Dardhishtë, komuna e Fushë Kosovës dhe është obliguar KEDS/KESCO që t'i ofrojnë aplikuesit Sh.S. lidhje të re, respektivisht kycjen në rrjetin elektrik, konform kërkesës për lidhje të re.

Kundër këtij vendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë/kundërshtim në Zyrën e Rregullatorit për Energji, parashtuar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, me datë 25.06.2020, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, për konsumatorin Sh.S., lidhur me kërkesën për lidhjen e re, si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: se me rastin e blerjes së paluajtshmërisë nga pronari M.H.B. blerësi i ri, në këtë rast Sh.S., sipas Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, tek pjesët për kontrata është e specifikuar se blerësi me blerje i pranon të drejtat dhe detyrimet, respektivisht e ka blerë pronën me ngarkesë. KESCO në kundërshtimin e tyre kanë theksuar po ashtu që blerësi i ri, ka qenë ose është dashur të jetë në dijeni të ngarkesave komunale që ka prona në fjalë me rastin e shitblerjes së pronës dhe për të njëjtat të arrij marrëveshje me shitësin. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2056_06_20 të datës 02.06.2020 për konsumatorin Sh.S..

Bordi i ZRrE-së duke u bazuar në nenin 14, par.5, nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, pas ekzaminimit të vendimit të atakuar, kundërshtimit të KESCO-s dhe provave tjera materiale që gjenden në shkresat e lëndës, konstatoi se:

- Ankesa/kundërshtimi nuk është i themeltë.



Sa i përket kundërshtimit të KESCO-s se blerësi i ri, në këtë rast, Sh.S., e ka blerë pronën me ngarkesë, respektivisht se me rastin e lidhjes së kontratës i pranon të drejtat dhe detyrimet që lidhen me pronën, Bordi i ZRrE-së, pas analizimit dhe vlerësimit të provave, e në veçanti të Kontratës për Shitblerjen e Paluajtshmërisë, e lidhur dhe e notërizuar me datë 22.08.2017, tek Noteri Naim Rrecaj në Obiliq, në nenin 7 – Kushtet Shitjes, të kontratës, pika 2 - Garancionet, në mënyrë decitive ceket që: *“Shitësi i siguron blerësit se paluajtshmërinë që e shet nuk ka kurrfarë të metash që ky i dinë e ia fshehtë blerësit, me çka në plotëni veprohet në harmoni me nenin 461 e 491 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve”*. Andaj, është konstatuar se, me asnjë provë ose dokument nuk është vërtetuar pretendimi i KESCO që pala i ka pranuar të drejtat dhe detyrimet që lidhen me pronën, përkundrazi, nëse prona është blerë me ngarkesë financiare, është në përgjegjësi të shitësit – M.H.B. që sipas kontratës së lartëcekur, i njëjti do të bart përgjegjësinë për mashtrim të blerësit dhe të noterit.

Më tej, Bordi i ZRrE-së sqaron se, kërkesa për lidhje të re të një konsumatori mund të refuzohet vetëm për shkak të mospërbushjes së kushteve teknike, dhe se ekzistimi i një shifre tjetër në pronën e pronarit të ri, nuk është bazë e mjaftueshme për refuzim, e një gjë e tillë është paraparë shprehimisht në nenin 5, par.3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku sqarohet se *“Operatori i Sistemit është i obliguar të bëjë kyçjen në rrjet të çdo aplikuesi, nëse kjo kyçje është teknikisht e mundshme, sipas kushteve të vendosura në Marrëveshjen për Kyçje ...”*. Në nenin 10, par. 1, të Rregullës së lartëcekur është e përcaktuar që Operatori i Sistemit mund të refuzoj ta kyç një aplikues përkohësisht, vetëm nëse ajo kyçje është në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit dhe Shpërndarjes ose kodeve tjera në fuqi. Duhet theksuar se KESCO dhe KEDS të rasti i konsumatorit Sh.S., kërkesa për lidhje të re nuk është refuzuar për shkak të mos përbushjes së kushteve teknike, por vetëm që ekziston një shifër DPR – 90028350.

Bordi i ZRrE-së bazuar në të gjitha shkresat e lëndës konstaton se shifra DPR – 90028350 në të cilën KESCO dhe KEDS e ka refuzuar aplikuesin për lidhje të re – Sh.S., pasi që shifra është e regjistruar në emër të M.B. Gjithashtu, duhet theksuar se sipas kontratës për shitblerjen e paluajtshmërisë, shihet se shitësi është M.B. dhe se blerësi është S.S. andaj, aplikuesi nuk ka të bëjë asgjë me borxhin e energjisë elektrike që është krijuar më herët. Sipas dispozitave ligjore të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Furnizuesi duhet të faturojë dhe arkëtojë (mbledh) pagesat prej konsumatorëve, pra, furnizuesi KESCO ka qenë i obliguar kur e ka faturuar konsumatorin me shifër DPR – 90028350 (M.B.) edhe t'i arkëtojë pagesat me kohë, në harmoni me dispozitat ligjore, dhe në asnjë mënyrë nuk duhet që t'i kërkojë ato nga blerësi i ri (Sh.S.) i cili ka aplikuar për lidhje të re. KESCO duhet që borxhin e energjisë elektrike të krijuar në shifrën DPR – 90028350 ta kërkojë përmes procedurave ligjore, por jo ta pengoj aplikuesin në fjalë që të ketë lidhje të re. Andaj, Bordi i ZRrE konstaton se KEDS/KESCO aplikuesi Sh.S. lidhjen e re, respektivisht kyçjen në rrjetin elektrik.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.08.2020 ka analizuar ankesën e KESCO dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr.ZRRE/DMK_V_2056_06_20, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit Sh.S. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.